



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Shk.II.nr.1040/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP Vëllëzërit Gashi me seli në Skënderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.H. avokat në Prishtinë, kundër të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, vlersim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditues kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.36/22 datës 29.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.11.2023, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditues Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.36/22 i datës 29.05.2023, Vërtetohet

### A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar, Dhoma e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke Aprovuar në tërsi si të bazuar Kërkesëpadin e paditësit NTP Vëllëzërit Gashi me seli në Skënderaj, ka Anuluar Pjesërisht vendimin e të paditurit ATK-së, nr.10/2019 dt.06.03.2019, dhe atë vetëm lidhur me vlersimet tatimore kontestuese në shumat e gjykuara si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, ka Obliguar të paditurin Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTP Vëllëzërit Gashi me seli në Skënderaj, t,ia rimbursoi mjetet e paguara më tepër në shumë prej 14,451.31€ dhe atë në emër të TVSH-së shumë prej 6,964.81€, ndërsa në emër të Tatimit në të Ardhura Personale shumë prej 7,486.50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit

të këtij aktgjykimi, dhe ka lën në fuqi vendimin e të paditurit ATK-së, nr.10/2019 dt.06.03.2019, dhe atë lidhur me vlersimet tatimore, jo kontestuese përtej shumave të gjykuara si më lartë, dhe secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes së dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe propozon që të aprovohet ankesa e ATK-së, si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.36/22 i datës 29.05.2023, dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Administrata Tatimore e Kosovës-Departamenti i Ankesave, me vendimin nr.10/2019 datës 06.03.2019, ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit tatimor NTP Vëllëzërit Gashi me seli në Skënderaj, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë për periudhat e kontrollit vërtetohen si të bazuara.

Kundër këtij aktvendimi përfundimtar të nxjerr në procedurën administrative, nga Departamenti për Ankesa të ATK, paditësi NTP Vëllëzërit Gashi me seli në Skënderaj, me padi inicicion konflikt administrativ, në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29.05.2023, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt, dhe administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin aprovon kërkespadin e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Dhoma e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit thekson se e paditura pa të drejtë e ka ngarkuar

paditësin me arkullim shtesë mbi bazën e deponimeve-huazimeve duke i trajtuar si shitje të tatueshme, pasi që paditësi këto deponime i ka trajtuar si huazime ku për të njëjtat ka paraqitur provat si kontrata mbi huazimet, ku në mungesë të llogarisë bankare paditësi e ka shfrytëzuar llogarin bankare të biznesit për këto huazime. Nga vlersimeet e ekzspetizës financiare dates 20.12.2022 rezulton se ATK e ka ngarkuar më tepër paditësin me obligime shtesë pa mbështetje dhe atë me TVSH shumën prej 6,964.81€ me tatim në të Ardhura Personale në shumën prej 7,486.50€, ndërsa ngarkesa me kontribut pensional të pronarit në shumën prej 6,000.00€ është caktuar në mënyrë të drejt. Gjykata ia dha besimin e plotë ekspertizës financiare ngase i përmban elementet e nevojshme dhe të mjaftueshme të cilat gjykata i konsideroi të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare. Nga provat e administruara kontratat e huazimeve per periudhen 2013-2015 së bashku me kërkesat per konfirmim, gjykata ka vërtetuar se pronari i biznesit këtu paditësi ka pasur deponime-huazime nga personat e afërm të cilat nuk janë për qëllime biznesi. Gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43 par.3 dhe 46 par,3 të LKA-së, e miratoj kërkespadin e paditësit.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave ligjore, dhe as me shkelje, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i dhomës së shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e aprovuar kërkespadin e paditësit, dhe ka anuluar pjesërisht vendimin kontestues të paditues.

Pretendimet ankimore të paditues, Kolegji, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj Kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale apo ligjore siç pretendohet në ankes. Dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin, duke

vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore, ku pa dyshim vërtetohet se, e paditura gabimisht ka aplikuar dispozitat ligjore kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë per PD, TVSH dhe CI per periudhat tatimore 2013-2015 si rezultat i mos deklarimit të hyrave nga bankat.

Dhomat e shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vleron se e paditura ka ngarkuar paditësin me tatim shtesë nga deponimet ne llogari të biznesit per periudhat 2013-2015 duke i konsideruar si të hyra të pa deklaruar dhe këtë vlersim e paditura ATK-ja e referon ne nenin 14,15 dhe nenit 19 të Ligjit 03/L-222 per Administratën Tatimore dhe Procedurat, ndërsa gjatë gjykimit të rastit nga Dhoma e shkallës së parë, e paditura e cila nuk merr pjese në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk e mbështet vendimin e vet, në prejardhjen e të hyrave në llogarit bankare të paditësit për periudhen 2013-2015, për të vërtetuar vlersimet e kontrollit tatimor se paditësi ka të hyra të padeklaruar, por këto deponime i vleron si të hyra duke u bazuar vetëm në përshkrimet e llogarive bankare si deponime. Në kundërshtimin e ekspertizës financiare, datës 25.05.2023, e paditura, nuk ka provuar të dëshmoj të kundërtën e të gjeturave te ekspertizës, se a janë të hyra nga biznesi deponimet huadhënsve, për ti trajtuar si shitje për qëllime tatimore. Prandaj edhe kjo gjykatë vleron se këto veprime të paditurit respektivisht kontrollit tatimor për ti konsideruar si të hyra të padeklaruar, të hyrat në llogarin bankare të paditësit, janë të mangëta të pa argumentuara, dhe nuk gjejnë mbështetje në dispozitat e nenit 14, 15 dhe nenit 19 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kolegji pranon konstatimet e Dhomës së shkallës së parë, e cila gjendjen faktike e ka vërtetuar edhe përmes ekspertizës financiare datës 25.05.2023, ku vlersimi tatimor me të cilin është ngarkuar paditësi rezulton të jetë pjesërisht i drejt, prandaj në këtë rast me të drejt Dhoma e shkallës së parë ka nxjer aktgjykimin me të cilin aprovon kërkespadin e paditësit dhe anulon pjesërisht vendimin nr.10/2019 dt.06.03.2019 i paditurit ATKsë, duke vendosur si ne dispozitiv të aktgjykimit.

Pretendimet e të paditures në ankes, Kolegji nuk i aprovoi si të drejta. E paditura në ankes nuk ka dhënë shpjegime të arsyeshme dhe të argumentuara të zbatuara nga kontrolli tatimor, për të mbështetur pretendimet se vlersimi i kontrollit gjen mbështetje në legjislacionin tatimor.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhomat e shkallës së dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cënuar ligji në dëm të paditurës, sepse Kolegji, nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura, nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji, vlerëson, se Dhoma e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e LKA-së dhe dispozitat e legjislacionit tatimor.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe neni 49 i LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1040/2023 datë 17.11.2023

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Krenar Berisha